



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 shtator 2015
Nr. ref.: RK 841/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI31/15

Parashtrues

Tomislav Ilić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, Ka. nr. 2/III/ 2015, të 4 shkurtit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Tomislav Ilić (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Nish, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. nr 2/III/2015, të 4 shkurtit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Ka. nr 2/III/ 2015] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 4 shkurtit 2015.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 mars 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI31/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI31/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 21 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës. Njëkohësisht, kërkoi nga Gjykata e Apelit informata shtesë lidhur me pretendimet e parashtruesit se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, i 4 shkurtit 2015, nuk i është dorëzuar asnjëherë fizikisht.
8. Më 28 maj 2015, Gjykata e Apelit u përgjigj në kërkesën e Gjykatës.
9. Më 1 korrik 2015, me Vendimin GJR. KI31/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Enver Hasani, të cilit i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuese më 26 qershor 2015.
10. Më 7 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 17 shtator 2012, zyrtarët e Doganës së Kosovës, në vendkalim kufitar, ia morën parashtruesit një shumë të caktuar të mjeteve monetare në vlerë, e cila sipas nenit 29 të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, nr. 03/L-196, duhet të kishte qenë e deklaruar para shërbimit kompetent doganor gjatë hyrjes apo gjatë daljes nga territori i Kosovës.

12. Më 25 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, mori Aktvendim [Reg. nr. 10118/12-2], me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes nga neni 29.4 të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Në konkludimin e Aktvendimit thuhet: *„Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit”*.
13. Më 18 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet përfaqësuesit të tij juridik, z. Ž. J., paraqiti ankese në Gjykatën e Apelit ndaj Aktvendimit [Reg. nr. 10118/12-2] të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, të 25 qershorit 2014.
14. Më 5 gusht 2014, Gjykata e Apelit mori Aktvendim [PO. nr. 713/2014], me të cilin e hodhi poshtë si të paafatshme ankesën e përfaqësuesit juridik të parashtruesit, z. Ž. J., në pajtim me nenin 216 të Ligjit për Kundërvajtje (në tekstin e mëtejme: LK).
15. Më 1 dhjetor 2014, parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën e Apelit, në të cilën kërkoi rishqyrtimin e Vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, të 25 qershorit 2014, dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 5 gushtit 2014.
16. Më 4 shkurt 2015, Gjykata e Apelit mori Aktvendim [KA. nr. 2/III/2015], me të cilin e hodhi poshtë si të pasafatshme kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktvendimit të plotfuqishëm, me këtë arsye: *“Sipas dispozitës së nenit 237 të LK-së, është paraparë se kërkesa për rishqyrtim të aktvendimit të formës së prerë mund të paraqitet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktvendimi ka marrë formën e prerë, dhe duke pasur parasysh se parashtruesi përmes përfaqësuesit juridik e pranoi aktvendimin më 16 gusht 2014, i cili fakt dëshmohet me anë të librit të dërgesave postare, ndërsa kërkesën për rishqyrtim të aktvendimit e ka dërguar përmes postës më 1 dhjetor 2014, del se kërkesa për rishqyrtim të aktvendimit të formës së prerë është paraqitur pas afatit të përcaktuar, prandaj e njëjta u hodh poshtë”*.

Ligji relevant

17. Ligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Nr. 03/L-196:

Neni 29. Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës – Detyrimi për të deklaruar

“1. Secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës, para nëpunësit të autorizuar dhe nëse kjo kërkohet nga nëpunësi, ai duhet ti paraqesë këto mjete monetare [...]”

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në procedurën e rregullt nuk pati mundësi t'ua parashtrojë pyetje dëshmitarëve, se gjykatat nuk ia kishin dorëzuar aktvendimet, si dhe që nuk pati mundësi për t'i paraqitur ankesat.
19. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të prishë Aktvendimin [Reg. nr. 10118/12-2] e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, të 25 qershorit 2014, dhe Aktvendimin [PO. nr. 713/2014] e Gjykatës së Apelit, të 5 gushtit 2014, apo t'i ndryshojë vendimet dhe ta pezullojë procedurën, si dhe ta lirojë parashtruesin e kërkesës nga përgjegjësia.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse kërkesa ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë kuptim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës përcakton:

“Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

22. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

23. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) *“Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

24. Gjykata vëren se parashtruesi e ka ndërtuar ankesën e tij kushtetuese mbi pretendimet se ai në procedurën e rregullt është penguar t'i ndër marrë veprimet e parashikuara me ligj, gjë e cila, siç thuhet, ka shkaktuar shkeljen e nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], të nenit 46

[Mbrojtja e Pronës] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

25. Gjykata, duke analizuar shkresat e lëndës të dorëzuara nga Gjykata e Apelit më 28 maj 2015, konstatoi se parashtruesi, më 19 shtator 2012, autorizoi përfaqësuesin juridik, i cili sipas autorizimit ka qenë i autorizuar për t'i ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale të lejuara me ligj dhe për paraqitjen e mjeteve të përcaktuara juridike brenda afatit të paraparë me ligj.
26. Gjykata vëren më tej se në bazë të fletëdorëzimit Nr. 10.118/12.2, vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës-Dega në Podujevë, i 25 qershorit 2014, i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit më 9 korrik 2014, ndërsa, në bazë të fletëdorëzimit Nr. 10.118/12.2, vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i 4 shkurtit 2015, i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit më 30 mars 2015.
27. Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Ka. nr. 2/III/ 2015] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 4 shkurtit 2015, Gjykata konsideron se në procedurën para Gjykatës së Apelit është vendosur mbi ekzistencën e kushteve ligjore për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë, dhe se nuk është vendosur mbi esencën e kontestit, respektivisht nuk është vendosur mbi meritat sipas kërkesës së parashtruesit.
28. Sipas vlerësimit të Gjykatës, Gjykata e Apelit e ka bazuar Aktvendimin e saj [KA. nr. 2/III/2015], me të cilin e kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit, të 4 shkurtit 2015, në dispozitën relevante ligjore të nenit 237 të LK, e cila parashikon:

„Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm paraqitet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm paraqitet me shkrim në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje”.
29. Rrjedhimisht, në këtë rast nuk ka asgjë që tregon se parashtruesi i kërkesës, në kohën e duhur, ka kontestuar në gjykatat e rregullta nëse ka pasur zbatim arbitrar të procedurave ligjore në dëm të parashtruesit.
30. Gjykata më tej ripërsërit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, rastin *KI70/11*, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
31. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kërkesat për pranueshmëri, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar që vendimi i kontestuar shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ose me KEDNJ.

32. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi